



RAPORT TRANSPARENCE Viti 2024

Përmbajtja

<i>Mesazhi i drejtimit "ACC GLOBAL FINCORP" sh.p.k</i>	2
1. Rreth ACC GLOBAL FINCORP	3
1.1. Misioni Ynë	3
1.2. Vlerat Tona	3
2. Fokus i ri për Transparencën tonë	4
3. Fokus mbi Angazhimet dhe marrëdhëniet me klientet	5
3.1. Pranimi i klienteve dhe vazhdimësia	5
3.2. Vlerësimi i riskut të klientit	5
3.3. Vlerat dhe kultura e biznesit	5
3.4. Sigurimi i cilësisë	6
3.5. Deklaratat e pavarësisë	6
3.6. Kontrollat e konfliktit të interesit dhe pavarësisë.....	6
3.7. Monitorimit të praktikave pavarësisë	7
4. Përse duhet të zgjidhni "ACC GLOBAL FINCORP"	7
5. Shërbimet e "ACC GLOBAL FINCORP" sh.p.k	8
5.1. Shërbime Financiare dhe Kontabiliteti	8
5.2. Shërbime të Auditimit dhe Sigurisë.....	8
5.3. Konsulencë Ekonomike, Financiare dhe Fiskale	9
5.4. Vlerësime të Aktiviteteve Tregtare.....	10
5.5. Vlerësime të Pasurive të Luajtshme & Paluajtshme	10
5.6. Përgatitje Plan Biznes.....	10
5.7. Shërbime Këshillimi të Specializuara.....	10
6. Industrinë	11

Mesazhi i drejtimit "ACC GLOABL FINCORP" sh.p.k.

Në Studion "ACC GLOBAL FINCORP" sh.p.k., ne jemi të përkushtuar ndaj standardeve më të larta të saktësisë financiare dhe integritetit profesional në shërbim të klientëve tanë. Ne kuptojmë se në një mjedis biznesi gjithnjë e më kompleks dhe dinamik, informacioni financiar i saktë dhe i rregullt është themeli i çdo vendimmarrjeje strategjike të suksesshme.

Misioni ynë është të ofrojmë partneritet të besueshëm dhe shërbime kontabiliteti, tatimore dhe këshillimore të nivelit më të lartë, duke ndihmuar bizneset, investitorët dhe sipërmarrësit të navigojnë me sukses kornizën ligjore dhe rregullatore. Përmes aplikimit rigoroz të Standardeve Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Auditimit (SKK/SNK) si dhe të zbatimit të përpiktë të legjislacionit tatimor në fuqi, ne sigurojmë transparencë dhe pajtueshmëri të plotë për subjektet që asistojmë.

Në "ACC GLOBAL FINCORP", ne besojmë se inovacioni dhe teknologjia janë kyçe për të rritur efikasitetin në profesionin tonë. Këtë synojmë ta realizojmë me anë të trajnimeve të vazhdueshme në Fintech dhe të gjuhëve të programimit.

Investimi ynë i vazhdueshëm në trajnimin dhe zhvillimin profesional si dhe pasioni për përhapjen e njohurive në fushën e kontabilitetit dhe të auditimit na ka ndihmuar në rrugëtimin tonë për tu licensuar edhe si qëndër formimi profesional, ku tashmë studio jonë bërë shtëpia e mikpritjes së shumë studenteve ndër vite.

"ACC GLOBAL FINCORP" është partneri juaj i sigurt për qëndrueshmërinë dhe rritjen financiare të sipërmarrjes suaj.



1. Rreth ACC GLOBAL FINCORP

Studio Kontabël ACC GLOBAL FINCORP” sh.p.k. përfaqëson një qasje bashkëkohore në fushën e auditimit dhe konsulencës ekonomike-financiare që prej themelimit të saj më 17/11/2020, e cila ofron shërbime në fushën financiare të tilla si:

- Konsulencë fiskale dhe financiare duke përfshirë edhe
- analizat dhe raportimet financiare,
- Shërbime kontabiliteti dhe mbajtje pasqyrash financiare,
- Shërbime konsulencë ligjore dhe përfaqësim ligjor,
- Hartimi i Pasqyrave Financiare dhe Rishikimi të pasqyrave financiare,
- Shërbime të tjera konsulencë për banka, shoqëri tregtare, organizata jofitimprurese dhe persona të tjerë juridik,
- Kryerja e shërbimeve të auditimit të brendshëm për kompani dhe organizata,
- Vlerësim biznesesh,
- Shërbime të auditimit ligjor,
- Zhvillim i eventeve, trajnimeve dhe kurseve të formimit profesional në fushën e financës, kontabilitetit, biznesit.

Me aktivitetin e saj në Tiranë, pranë rrugës "Shyqyri Berxolli", Kati 5, Hyrja 20B studioja ofron një mjedis optimal për administrimin me përgjegjshmëri të çdo angazhimi profesional.

1.1. Misioni Ynë

Misioni i studios kontabël "ACC GLOBAL FINCORP" është pozicionimi në tregun Shqiptar si model për ofrimin e shërbimeve financiare me një integritet të lartë profesional dhe etik duke mbështetur vazhdueshëm klientet në një ambient dinamik dhe inovator.

1.2. Vlerat Tona

- Profesionalizmi, integriteti, si dhe etika janë vlerat kryesore të studios "ACC GLOBAL FINCORP".
- Investohemi në plotësimin e nevojave financiare të klientëve tanë.
- Komunikim i hapur dhe i qartë me klientin për pozicionin e tyre financiar.
- Mbrotjtja e të dhënave të ndjeshme financiare të klientit si informacioni më i rëndësishëm i biznesit.



2. Fokus i ri për Transparencën tonë

Në Studion Kontabël “ACC GLOBAL FINCORP” ne udhëhiqemi nga parimi se integriteti i auditimit është shtylla kryesore e besimit në raportimin financiar. Duke pasur si synim parësor ofrimin e një shërbimi ekselent, ne analizojmë me kujdes çdo faktor të brendshëm dhe të jashtëm që ndikon në tregjet tona. Angazhimi ynë mbetet i palëkundur: t'u sigurojmë klientëve tanë auditime me vlerë të lartë dhe saktësi absolute.

Cilësia e proceseve tona ka qenë historikisht prioriteti ynë kryesor. Falë investimit të vazhdueshëm në burime njerëzore dhe teknologji, kemi ndërtuar një ekspertizë të konsoliduar që na lejon të përballemi me sukses me sfidat e sektorit. Kjo qasje na garanton mundësinë për të përmbushur çdo kërkesë të klientëve në përputhje të plotë me rregulloret në fuqi, duke shmangur çdo vonesë apo problematikë.

Proceset tona ndjekin me rigorozitet Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë dhe kërkesat etike të fushës, duke garantuar mbarëvajtjen e çdo angazhimi profesional.

Në mbështetje të nenit 45 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", më poshtë paraqesim të dhënat e detajuara mbi performancën tonë financiare.

Të ardhurat e studios për vitin 2024 janë të kategorizuara si vijon:

Lloji shërbimit	Studio”ACC GLOBAL FINCORP” sh.p. k 2024	Ne 000/lek
Auditim Ligjor të njësive ekonomike me interes publik (NIP)	480	
Sherbime kontabiliteti dhe konsulence	6,517	
Total	6,997	

Tabela 1: Te ardhurat për vitin 2024, sipas shërbimeve

Në menyrë të detajuar paraqesim listën e entiteteve me interes publik të audituara nga studio jonë gjatë vitit 2024, sipas Tabelës. 2 më poshtë:

Nr.	Entiteti	Nr.	Entiteti
1	Usluga Shpk	1	480 All

Tabela 2: Lista e entiteteve NIP të audituara për vitin 2024

Realizimi i auditimeve ligjore cilësore bazohet mbi të gjitha në besueshmërinë e institucioneve mbikëqyrëse dhe partnerëve që mbështeten në punën tonë. Për të forcuar këtë besim, studioja operon me integritet dhe kujdes të shtuar në çdo angazhim, duke synuar standardet më të larta në shërbimet audituese dhe ato konsulente.

Ju ftojmë të shqyrtoni këtë Raport Transparence për vitin 2024, i cili pasqyron angazhimin maksimal për cilësi, transparencë dhe zbatimin e parimeve strikte profesionale në çdo fazë të veprimtarisë së studios.

3. Fokus mbi Angazhimet dhe marrëdhëniet me klientet

3.1. Pranimi i klienteve dhe vazhdimësia

Përpara fillimit të çdo marrëdhënieje profesionale, studioja zbaton një proces rigoroz vlerësimi. Gjatë kësaj faze, dokumentohen dhe analizohen faktorët kryesorë si:

- Kompetenca teknike: Vlerësimi i aftësive specifike të ekipeve të angazhimit në raport me kërkesat e subjektit;
- Pavarësia: Konfirmimi i objektivitetit të firmës dhe partnerëve për çdo angazhim të ri;
- Profili i rrezikut: Analiza e integritetit të klientit dhe mjedisit të tij të biznesit;
- Faturimi profesional: Sigurimi që tarifat janë në përputhje me kompleksitetin e punës, duke garantuar cilësinë pa krijuar varësi ekonomike.

3.2. Vlerësimi i riskut të klientit

Përmbushja e kërkesave ligjore dhe rregullatore bazohet në kuptimin e thellë të rreziqeve specifike të çdo subjekti. Kjo analizë është thelbësore për të garantuar një shërbim ekselent dhe të certifikuar. Studioja operon me një politikë strikte të vlerësimit të riskut, e cila përcakton procedurat standarde për identifikimin e rreziqeve gjatë gjithë ciklit të auditimit.

3.3. Vlerat dhe kultura e biznesit

Strategjia e studios bazohet në përzgjedhjen e subjekteve që ndajnë vlera të ngjashme etike dhe profesionale. Kultura e biznesit promovon integritetin dhe përgjegjshmërinë përmes trajnimeve të vazhdueshme mbi rreziqet ndaj pavarësisë. "ACC GLOBAL FINCORP" synon të ofrojë një mjedis profesional ku saktësia dhe etika janë parësore.

Pavarësia e studios dhe partnerëve administrohet përmes politikave dhe sistemeve të brendshme që adresojnë kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Këto procedura garantojnë që çdo marrëdhënie me klientët të jetë e sigurt, transparente dhe në përputhje me standardet më të larta të shërbimeve audituese dhe jo-audituese.

Studio Kontabël "ACC GLOBAL FINCORP"

Pavarësia e Studios administrohet përmes politikave, procedurave dhe sistemeve të brendshme të kontrollit, të dizajnuara për të adresuar parimet dhe kërkesat sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Këto rregullore sigurojnë mbikëqyrjen e vazhdueshme të marrëdhënieve me klientët e auditimit ligjor, integritetin e proceseve, strukturën e tarifave dhe ofrimin e shërbimeve jo-audituese në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

3.4. Sigurimi i cilësisë

"ACC GLOBAL FINCORP" operon me përkushtim të plotë ndaj standardeve më të larta të integritetit dhe profesionalizmit në çdo angazhim. Kuadri rregullator zbatohet me rigorozitet në të gjitha dimensionet e veprimtarisë, duke përfshirë:

- Kodin e Etikës: Respektimi i Kodit të Etikës për Kontabilistët Profesionalistë të lëshuar nga IFAC (përmes IESBA).
- Standardet e Auditimit: Kryerja e auditimeve në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të lëshuara nga IAASB.
- Kontrolli i Cilësisë: Zbatimi i Standardit Ndërkombëtar të menaxhimit të Cilësisë (SNMC) të IFAC.

Për të garantuar këtë nivel ekselence, "ACC GLOBAL FINCORP" ka implementuar një sistem të brendshëm të kontrollit të cilësisë. Ky sistem është projektuar për të ofruar siguri të arsyeshme se veprimtaria profesionale kryhet në përputhje me kërkesat ligjore, duke siguruar që raportet e lëshuara të jenë plotësisht të përshtatshme për rrethanat specifike.

Studio nuk ka qenë subjekt i kontrollit të cilësisë nga momenti i regjistrimit dhe për periudhën/vitin 2024.

3.5. Deklaratat e pavarësisë

Ruajtja e pavarësisë është një parim themelor për studion tonë. Procesi i deklarimit fillon që në fazën e rekrutimit, ku partnerët dhe stafi konfirmojnë se marrëdhëniet e tyre financiare, biznesi apo personale nuk bien ndesh me politikën tona të pavarësisë.

Për të siguruar një monitorim të vazhdueshëm:

- Deklarimi Vjetor: Çdo anëtar i personelit dorëzon një deklaratë zyrtare pavarësie në fillim të çdo viti.
- Konfirmimi për Angazhim: Përpara fillimit të çdo auditimi ligjor, të gjithë anëtarët e ekipit (përfshirë ekspertët e jashtëm) duhet të deklarojnë pavarësinë e tyre specifike për atë klient.

Këto deklarata dokumentohen me kujdes dhe arkivohen në dosjen përkatëse të angazhimit si provë e përputhshmërisë me standardet etike.

3.6. Kontrollat e konfliktit të interesit dhe pavarësisë

Sistemi i menaxhimit të pavarësisë siguron demonstrimin e pajtueshmërisë me kërkesat profesionale, rregullatore dhe ligjore, duke dokumentuar çdo rrethanë të konflikteve dhe zgjidhjet përkatëse.

Një kontroll i detajuar i konfliktit të interesit dhe pavarësisë kryhet përpara pranimit të çdo angazhimi të ri. Ky kontroll rishikohet në mënyrë periodike çdo vit për të gjithë klientët e listuar të auditimit, si pjesë e procedurave standarde të vazhimit të marrëdhënies me klientin.

Kur identifikohet një konflikt, strukturat përgjegjëse të vlerësimit të riskut udhëheqin procesin e zgjidhjes së tij, duke u konsultuar me udhëzimet e funksionit Kombëtar të riskut dhe etikës. Në rastet kur një konflikt nuk mund të adresohet përmes masave të duhura mbrojtëse, studioja nuk e pranon angazhimin ose ndërpret veprimtarinë për atë projekt.

Studio nuk ofron konsulence për klientët që auditon.

Ne kemi politika dhe procedura të vendosura për të identifikuar dhe zgjidhur çdo kërcënim ndaj pavarësisë të krijuar duke ofruar shërbime mos-dhenie sigurie për klientët e auditimit. Partneri i angazhimit të auditimit aprovon çdo shërbim mos-dhenie sigurie të propozuar një klienti të auditimit para se të kryhen shërbimet e mos-dhenies se sigurise. Partneri i angazhimit të auditimit merr në konsideratë çdo konflikt interesi ose kërcënime ndaj pavarësisë që mund të lindë përpara aprovimit të shërbimit të mos-dhenies se sigurise. Sigurimi dhe aprovimi i shërbimeve jo-audituese gjithashtu është rishikuar në mënyrë specifike në një nivel angazhimi, si pjesë e Programit vjetor të kontrollit të brendshëm të firmës.

3.7. Monitorimit të praktikave pavarësisë

Monitorimi i praktikave të pavarësisë kryhet përmes një sërë aktiviteteve rishikuese, të cilat përfshijnë:

- Deklarimet vjetore: Mbledhja dhe analizimi i deklaratave periodike të pavarësisë për çdo angazhim; në rastet e mospërputhjeve, zbatohen procedura të menjëhershme hetimi dhe zgjidhjeje.
- Auditimi i brendshëm: Realizimi i auditimit vjetor mbi sistemet e kontrollit për të garantuar integritetin e proceseve.

4. Përse duhet të zgjidhni Studio Kontabël "ACC GLOBAL FINCORP" shpk



- Prioriteti mbi Cilësinë: Objektivi kryesor mbetet dobia dhe vlera e shtuar që përfitohet nga shërbimet e certifikuara.
- Raporti Optimal Çmim/Cilësi: Ofrimi i shërbimeve me kosto konkurruese pa cenuar standardet profesionale të auditimit.
- Shërbime të Personalizuara: Zhvillimi i zgjidhjeve specifike që adresojnë nevojat unike të çdo subjekti dhe industrie.
- Përditësim i Vazhdueshëm: Aplikimi me rigorozitet i Standardeve të Raportimit Financiar dhe ndryshimeve ligjore që rregullojnë fushën e financës në Shqipëri.

5. Shërbimet e Studio Kontabël" ACC GLOBAL FINCORP" sh.p.k.

5.1. Shërbime Financiare dhe Kontabiliteti

Ofrimi i shërbimeve tona kontabël synon të rrisë efikasitetin operacional të biznesit tuaj duke minimizuar kostot. Ne ju asistojmë në menaxhimin e plotë të ciklit financiar duke filluar nga mbylljet mujore e tremujore deri te hartimi i pasqyrave vjetore gjithmonë në përputhje me ndryshimet e fundit në legjislacion dhe standardet kombëtare. Partneriteti me ne ju garanton një tranzicion të sigurt drejt sistemeve më të avancuara të kontabilitetit, duke ju lejuar të fokusoheni plotësisht në rritjen e biznesit tuaj.



5.2. Shërbime të Auditimit dhe Sigurisë

- Auditimin e Pasqyrave Financiare: Verifikim rigoroz sipas Standardeve Ndërkombëtare (ISA) dhe kornizave kontabël në fuqi (KKK/SNRF).
 - Raportimin për Grupin: Auditim i raporteve financiare për nevoja të konsolidimit të grupeve të shoqërive.
 - Vlerësimin e Kontrolleve të Brendshme: Analizë e detajuar dhe rishikim i mekanizmave kontrollues për të rritur sigurinë.
 - Auditimet Sektoriale: Kontrolli i përputhshmërisë bazuar në kërkesat specifike dhe rregulloret e industrive të veçanta.
 - Shërbime të Sigurisë (Assurance): Procedura të dakorduara paraprakisht dhe shërbime sigurie të personalizuar sipas nevojave të klientit.
- “Audituesit luajnë një rol të rëndësishëm në verifikimin e informacionit financiar. Besimi i klienteve në cilësinë e punës së auditimit është parësor. Përmes raporteve të transparencës audituesit mund ti tregojnë tregut cilësinë dhe besueshmërinë e auditimeve të tyre”.

Auditimi i pasqyrave financiare përfshin ekzaminimin e pasqyrës së pozicionit financiar, pasqyrës së fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrës së ndryshimeve të kapitalit dhe flukseve të parave. Ky proces përfshin gjithashtu shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare të konsoliduara dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.



“ACC GLOBAL FINCORP” operon me një sistem strikt të kontrollit të cilësisë dhe monitorimit. Ky sistem bazohet në politika dhe procedura të mirëpërcaktuara për të garantuar përmbushjen e objektivave profesionale në çdo angazhim. Proceset e auditimit kryhen nga ekspertë me kualifikimin e duhur, duke zbatuar me rigorozitet Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë dhe kërkesat etike. Veprimtaria e studios udhëhiqet nga parimet e Seksioneve 290 dhe 291 të Kodit IESBA, duke siguruar integritet dhe transparencë të plotë.



5.4. Konsulencë Ekonomike, Financiare dhe Fiskale

- Analizën e Implikimeve Fiskale: Vlerësim i detajuar i transaksioneve ndërkufitare (cross-border) për të garantuar efikasitet dhe pajtueshmëri ligjore.
- Marrëveshjet për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë: Konsulencë mbi avantazhet dhe kufizimet, si dhe asistencë teknike në procedurat e aplikimit për të përfituar nga këto traktate.
- Njesitë e Përhershme: Këshillim dhe asistencë specifike për menaxhimin e rreziqeve tatimore që lidhen me statusin e njësisë së përhershme.
- Shkëmbimin e Informacionit Fiskal: Mbështetje mbi implikimet dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare për transparencën financiare.
- Standardet e OECD: Aplikimi i rregullave dhe udhëzimeve të OECD-së për transaksionet ndërkombëtare dhe çmimet e transferimit.
- Analizën Strategjike të Taksave: Studim mbi impaktin e taksave në vendimmarrjen operationale dhe strategjike të shoqërive ndërkombëtare.

Sektorët kryesorë të angazhimit të firmës tonë përfshijnë: Shitjen me Pakicë, Turizmin dhe Hotelierinë, Shëndetësinë dhe Farmaceutikën, Teknologjinë e Informacionit dhe Telekomunikacionin, Shërbimet profesionale, Median dhe Marketingun, Organizatat Jofitimprurëse.

5.2. Vlerësime të Aktiviteteve Tregtare

Ofrimi i një konsulence tatimore gjithëpërfshirëse që garanton përputhshmërinë e plotë me kuadrin ligjor shqiptar. Shërbimet tona integrojnë planifikimin strategjik të taksave, asistencën direkte në zbatimin e traktateve ndërkombëtare dhe mbështetjen ligjore për të optimizuar strukturën financiare të biznesit tuaj.

5.3. Vlerësime të Pasurive të Luajtshme & Paluajtshme

Në proceset e zgjerimit, si shtimi i një partneri të ri biznesi apo tërheqja e investitorëve, vlerësimi i saktë i asetëve është i domosdoshëm. Ne ofrojmë raporte vlerësimi të certifikuar që pasqyrojnë vlerën reale të tregut për pasuritë e luajtshme dhe ato të paluajtshme, duke shërbyer si bazë e sigurt për negociime dhe transaksione kapitale.

5.4. Përgatitje Plan Biznes

Ne punojmë ngushtë me ju për të kuptuar qëllimet dhe vizionin tuaj, dhe pastaj të zhvillojmë një plan të qartë për biznesin tuaj për vitet e ardhshme. Ne shqyrtojmë supozimet, bëjmë hulumtime të pavarura, shqyrtojmë dhe propozojmë mënyra alternative për t'ju ndihmuar të arrini objektivat tuaja të biznesit. Ne jemi konsulentë, jo vetëm shkruar të plan-biznesit.

5.5. Shërbime Këshillimi të Specializuara

Shërbimet e këshillimit financiar studio kontabël "ACC GLOBAL FINCORP" sh.p. k është e specializuar në dhënien e shërbimeve financiare të mëposhtme:

- Due diligences financiare dhe operacionale;
- Bashkime dhe përthithje;
- Ristrukturimi i Biznesit;
- Vleresime të biznesit;
- Mbështetje për Partneritetet Publiko-Private;
- Analiza të Tregut dhe Studime Fizibiliteti.

6. Industritë

Studio "ACC GLOBAL FINCORP" ofron një sinergji mes njohurive teknike dhe përvojës praktike në tregun shqiptar. Ne nuk ofrojmë thjesht shërbime, por zgjidhje strategjike që përshtaten me dinamikën e çdo sektori ku operojnë klientët tanë, nga bizneset e mesme deri te korporatat e mëdha.

Përkushtimi ynë bazohet në ndërtimin e partneriteteve afatgjata. Ne investojmë kohë për të kuptuar vizionin dhe sfidat e klientit, duke gjeneruar rezultate inovative që optimizojnë performancën financiare dhe minimizojnë ekspozimin ndaj rreziqeve në mjedise rregullatore sfiduese.

Sektorët kryesorë të angazhimit të firmës tonë përfshijnë: Shitjen me Pakicë, Turizmin dhe Hotelierine, Shëndetësinë dhe Farmaceutiken, Teknologjinë e Informacionit dhe Telekomunikacionin, Shërbimet profesionale, Median dhe Marketingun, Organizatat Jofitimprurëse.



*Albana Veshi
Audituese Ligjore*

Eksperiencë &
Profesionalizëm

Pasion &
Përkushtim

Komunikim &
Motivim

Integritet & Kredibilitet

**Prezantim përmbledhës – Fokus te Cilësia dhe Etika
Profesionale sipas SNA-ve**

Albana Veshi, Auditues Ligjor pranë “ACC GLOBAL FINCORP” sh.p.k, ka një karrierë 15-vjeçare në sektorin ekonomik dhe financiar. Formimi i saj profesional mbështetet në studimet në Financë-Kontabilitet dhe të përfunduar në Universitetin e Tiranës.

Gjatë ushtrimit të detyrës si auditues ligjor, znj.Veshi demonstroi përkushtim të lartë ndaj cilësisë së shërbimit auditues, në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA/ISA) dhe Kodit të Etikës për Profesionistët e Financës.

Praktika e saj mbështetet në parime rigorozet e etikës, të cilat garantojnë një shërbim me besueshmëri të lartë:

- Integriteti dhe Objektiviteti.
- Konfidencialiteti.
- Konfidencialiteti dhe mbrojtja e informacionit, Kompetenca dhe kujdesi profesional,
- Sjellja profesionale dhe respektimi i kuadrit ligjor, Aftësia e saj për të ndjekur procedurën metodologjike të qarta siguron:
- Vlerësim objektiv dhe analitik të rreziqeve financiare,
- Dokumentim të saktë dhe të detajuar të çdo faze të procesit auditues,
- Transparencë dhe komunikim efektiv të konkluzioneve me subjektet e audituara,
- Vendimmarrje të bazuar ekskluzivisht në prova audituese dhe standarde profesionale,

Përvoja e gjatë në sektorin e ekonomisë, i jep profilin të saj një qasje të strukturuar, të pavarur dhe me standard të lartë profesional.

E drejtuar nga parimet e liderimit etik, znj. Veshi nxit kulturën e transparencës, saktësisë dhe përgjegjshmërisë, duke qenë një shembull i qartë i profesionalizmit në shërbim të interesit publik dhe të besueshmërisë financiare

SUCCESS



Implementation

Strategy

Goal

Mission

Vision

